



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

Бр. Nr. 08 - 6/26

18.05.2026 20

СКОПЈЕ ШКУП



Në bazë të Nenit 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për realizimin e eventeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese nga fusha e zhvillimit lokal ekonomik nr. 08-775/1 datë 26.01.2026, dhe në lidhje me Programin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25 dhe 3/26), Qyteti i Shkupit shpall:

Thirrje publike për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit "Organizimi i shikimit turistik të Shkupit"

1. LËNDA

1.1. Lëndë e Thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare për realizimin e projektit: **"Organizimi i shikimit turistik të Shkupit"** me qëllim zhvillimin, promovimin, mbështetjen dhe përmirësimin e turizmit, hotelerisë dhe tregtisë me rëndësi të jashtëzakonshme për qytetin e Shkupit.

2. E DREJTA PËR PJESËMARRJE

2.1. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë asociacionet dhe/ose shoqatat e guidave turistike dhe shoqëruesve turistikë që kanë përvojë në koordinimin dhe menaxhimin e stafit profesional, guidave dhe shoqëruesve dhe organizimin e tureve turistike dhe vizitave turistike në Shkup dhe Maqedoni, që janë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup, në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme të kësaj thirrjeje dhe kanë depozituar dokumentacionin e nevojshëm.

3. KORNIZA KOHORE DHE MËNYRA E SHPËRNDARJES SË MJETEVE

3.1. Mjetet financiare për realizimin e projektit **"Organizimi i shikimit turistik të Shkupit"** janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026.

3.2. Shfrytëzimi i mjeteve të ndara do të rregullohet me nënshkrimin e Kontratës ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe aplikantit i cili i plotëson kushtet themelore dhe kriteret e veçanta të përcaktuara për përzgjedhjen e propozim-projektit në Thirrjen publike dhe në përputhje me Rregulloren mbi mënyrën, kushtet, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për realizimin e aktivitetit projektues në fushën e zhvillimit lokal ekonomik.

4. KRITERE THEMELORE DHE TË VEÇANTA

4.1. Kriteret e veçanta dhe mënyra e pikëzimit për përzgjedhjen e aplikantëve janë parashikuar në Rregulloren për mënyrën, kushtet dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e eventeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit lokal ekonomik nr. 08-775/1 datë 26.01.2026, e cila është publikuar në ueb - faqen e Qytetit të Shkupit.

5. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM TË CILIN APLIKANTI DUHET TA DEPOZITOJË BASHKËNGJITUR ME APLIKIMIN

5.1. Për pjesëmarrje në thirrjen publike aplikanti detyrimisht duhet të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Aplikim i plotësuar me shkronja shtypi në alfabetin cirilik, i nënshkruar nga personi kompetent dhe i vërtetuar me vulën e aplikantit (aplikimi do të publikohet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit): www.skopje.gov.mk;
- Gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Aktvendim për regjistrimin e personit juridik me seli në Shkup;
- Deklaratë e nënshkruar për shlyerjen e detyrimeve ndaj Qytetit të Shkupit (tatim, taksa komunale);
- Vërtetim se nuk ka ndalim për pjesëmarrje në procedurat për thirrje publike, dhënien e kontratave të prokurimit publik dhe kontratave për partneritet publik privat (Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut);
- Propozim projekt i përgatitur me shkronja shtypi në alfabetin cirilik;
- Plani financiar i plotësuar me shkronja shtypi në alfabetin cirilik.

6. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

6.1. Aplikantët të bashkëngjitur duhet të depozitojnë edhe këtë dokumentacion shoqërues:

- biografi profesionale e ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e projektit,
- portofoli profesional - përshkrim i përvojës dhe aftësive organizative,
- së paku dy mendime/referenca nga partnerë ose donatorë për realizimin e aktiviteteve të mëparshme,
- përkrahje me shkrim nga organizata të tjera ose institucione për të cilat është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e aktivitetit dhe
- plan marketingu i aktivitetit.

7. MËNYRA E ZBATIMIT TË THIRRJES PUBLIKE

7.1. Për përcaktimin e plotësimit të kushteve themelore dhe kriterëve të veçanta, të përcaktuara në rregulloren për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit "Organizimi i shikimit turistik të Shkupit", kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për zbatimin e Thirrjes publike për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit "Organizimi i shikimit turistik të Shkupit" (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

7.2. Aplikimet që nuk janë depozituar në afatin e caktuar, të parregullta (të palexueshme) ose të pakompletuara dhe që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret do të refuzohen nga Komisioni me Konkluzion dhe nuk do të shqyrtohen, gjë për të cilën do të njoftojë aplikantët aplikimet e të cilëve janë refuzuar.

7.3. Për aplikimet që janë të kompletuara, të depozituara në afatin e caktuar dhe që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Rregullore, Komisioni depoziton propozim pranë kryetarit të Qytetit të Shkupit për përzgjedhjen e aplikantit për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit.

7.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit "Organizimi i shikimit turistik të Shkupit "

Vërejtje:

- ***Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar apo ato të depozituara pas afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Bashkëngjitjet e depozituara nuk do të kthehen.***
- ***Çdo aplikant mund të depozitojë vetëm një aplikim për thirrje publike të publikuar.***

8. AFATI DHE MËNYRA E DEPOZITIMIT TË APLIKIMEVE

8.1. Afati për depozitim e aplikimeve është 5 (ditë) nga dita e shpalljes së Thirrjes publike.

8.2. Aplikimi me dokumentacionin e plotë duhet të depozitohet në zarf të mbyllur nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit, çdo ditë pune ose në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shënim Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik – Aplikim për Thirrjen publike).

8.3. Aplikantët e Thirrjes publike do të njoftohen për rezultatet brenda 15 ditëve nga data e përfundimit të Thirrjes publike.

8.4. I gjithë dokumentacioni, aplikimi për mbështetje financiare, përmbajtja, kushtet, kriteret themelore/të veçanta (bashkëngjitje të aplikimit) dhe plani financiar për projektin janë në dispozicion në ambientet e Qytetit të Shkupit, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik, baraka nr. 6, çdo ditë pune dhe në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

8.5. Pyetjet sqaruese mund të depozitohen me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Sektorit për Zhvillim Lokal Ekonomik.

Telefoni kontaktues: (02)3297-284 dhe adresa email:

Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk dhe

(02)3297-272 adresa email: Gjorce.Aleksoski@skopje.gov.mk

QYTETI SHKUPIT